



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.252/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën Instituti Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. REFUZOHET e bazuar, ankesa e Instituti Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë Anr.252/2025 datë 29.01.2025, e parashtuar kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 29.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 28 Janar 2025, në orën 18:00, Koalicioni AAK-Nisma, ka mbajtur një tubim publik të fushatës zgjedhore në qytetin e Istogut, konkretisht tek Shtëpia e Kulturës "Adem Jashari".

Gjatë këtij tubimi, kandidati për deputet i këtij koalicioni Ramush Haradinaj, në fjalimin e mbajtur theksoi: " Cili është qëllimi i qeverisë që po shkon ose i këtij mashtruesi, a e dini cili është qëllimi, a ju ka treguar pashë Zotin....." Parashtruesi i ankesës konsideron se një terminologji e tillë, pra, përdorimi i termit "mashtruesi" si i tillë i përdorur gjatë këtij fjalimi përbën cenim të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, konkretisht, dispozitën e nenit 34 paragrafi 1, nën paragraf 1.11

Më tej në ankesë thuhet se një fjalim i tillë ku është theksuar termi 'mashtruesi', nga ana e këtij kandidati për deputet, përbën krahasim nxitës e provokues, e madje edhe urrejtës. Për më tepër, nga fjalimi i tërësishëm i kandidatit Ramush Haradinaj, ky lloj fjalimi nxitës e urrejtës

nënkuptohet që po i atribuohet apo dedikohet kandidatit të Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur linkun e publikuar në rrjetin social të Facebooku-t dhe një video CD.

<https://www.facebook.com/telegramnews.rks/videos/923162226693259/?vh=e&extid=MSG-UNK-UNK-UNKCOM GKOT-GKIC>

2. Fotografi ku paraqitet kandidati në fjalë me citimin e termit mashtruese.

Kërkojnë nga ana e PZAP-it, që të aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe që sipas në dispozitave të legjislacionit fuqi, të ndërmerre masë sanksionuese dhe të shqiptoi gjobën adekuate subjektit politik Koalicioni AAK-Nisma dhe kandidatit në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 30.01.2025, Koalicioni AAK, Nisma dhe Lista Ideal, i kundërshton në tërësi pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës, duke i konsideruar ato të pabazuara. Në asnjë moment, z. Ramush Haradinaj nuk ka bërë shkelje të dispozitës së lartcekur.

Pretendimi se subjekti AAK ka shkelur dispozitat e LZP-së është i pabazuar, pasi nuk ka asnjë veprim të drejtpërdrejtë që mund të konsiderohet si shkelje e ligjit.

Më tej në përgjigje në ankesë theksohet se deklarimi i z. Ramush Haradinaj se "Cili është qëllimi i këtij mashtruesi, a ju ka treguar pash Zotin", në asnjë moment nuk përmbush elementet materiale të dispozitës 1.11 të nenit 34 të LZP-së, dhe i njëjti ka shprehur opinion, duke aluduar në mos përmbushjen e premtimeve gjatë mandatit të z. Kurti si Kryeministër, dhe në një vend demokratik kritika dhe opozitarizmi si dhe kërkimi i llogaridhënies është VLERË

Kjo është një e drejtë themelore që garanton mundësinë e komunikimit të lirë dhe të hapur në shoqëri, duke mbrojtur shprehjen e mendimeve të ndryshme dhe të kundërta. Liria e shprehjes është një nga shtyllat kryesore të një shoqërie demokratike, e Cila mundëson shkëmbimin e ideve dhe rritjen e mendimit kritik dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli, pas shikimit të (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook - video incizimit të ofruar si provë materiale, e cila është publikuar nga kandidati për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët dhe Intelektualet, në tubimin e e Koalicionit, të mbajtur me datë 28.01.2025 në Shtëpinë e Kulturës "Adem Jashari, në Istog shihet se kandidati Ramush Haradinaj nga ky Koalicion, i ishte drejtuar elektoratit të tij duke përdorë fjalët "***Cili është qëllimi i qeverisë që po shkon ose i këtij mashtruesi, a e dini cili është qëllimi, a ju ka treguar pashë Zotin.....***", paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nga kandidati Ramush Haradinaj hynë në diskursin e fushatës zgjedhore dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decisive thuhet se: "***Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt***

të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Andaj Paneli, bazuar ne provat e ofruara ka ardhur ne përfundim se gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore te mbajtur me datë 28.01.2025 në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari, në Istog kandidati për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatoret dhe Intelektualet, ka vlerësuar se përdorimi i një gjuhe të tillë nuk bie në kundërshtim me nenit 34 pika l.11), e LZP-së,

Nga arsyet e theksuara me lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 252/2025 më datë 01.02.2025

**Kryesuese e Panelit,
Kymete Kicaj**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.